# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-402863**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shqipëria drejt BE-së, Mitsotakis vendos theksin te pronat dhe minoriteti grek: Ka progres, por të drejtat e minoritetit grek nuk janë mbrojtur mjaftueshëm |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/06/shqiperia-drejt-be-se-mitsotakis-vendos-theksin-te-pronat-dhe-minoriteti-grek-ka-progres-por-te-drejtat-e-minoritetit-grek-nuk-jane-mbrojtur-mjaftueshem/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 14:00:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 6 shtator 2026, 13:41:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 6 shtator 2026, 13:40:00 UTC → 6 shtator 2026, 13:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3eecfe464e136ab410add623638f0899f82060ca5f8e15381e72c7445df0c056` |
| TEKSTI | `37fade6a2d11c66208d6c5930eeb27dc4feae34e0b25aad90c6a14702801829c` |
| PAMJA | `931efea93015ff09b186fe99a62a4dd6fb6b0b3b9828e20ac49cf06fb889e007` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `261a56bd8ebe8b0265c75b4a04e9d3c04f8206ad8865fb0086856184003654b2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a42b88253b0c340fa02f24259d251e6e75ce4082f988432cb85d4a7dbcc5f14a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/261a56bd8ebe8b0265c75b4a04e9d3c04f8206ad8865fb0086856184003654b2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Shqipëria drejt BE-së, Mitsotakis vendos theksin te pronat dhe minoriteti grek: Ka progres, por të drejtat e minoritetit grek nuk janë mbrojtur mjaftueshëm

06/09/2026 15:41

Shqipëria dhe rruga e saj drejt Bashkimit Europian ishte një nga çështjet për të cilat u pyet në konferencën tradicionale për shtyp kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis, në kuadër të Panairit të 90-të Ndërkombëtar të Selanikut.

I pyetur për marrëdhëniet me Tiranën dhe problemet që lidhen me pronat dhe të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri, Mitsotakis tha se Athina mbështet perspektivën europiane të Ballkanit Perëndimor, por se çdo vend do të gjykohet veçmas për progresin e tij.

Kyriakos Mitsotakis, kryeministër i Greqisë u shpreh "*Progresi që është bërë në regjistrimin e pronave dhe në mbrojtjen e të gjitha të drejtave nuk është i mjaftueshëm. Të jeni të sigurt se, në momentin e duhur, do të ushtrojmë të drejtat tona për t'u siguruar që të drejtat e minoritetit mbrohen plotësisht.*"

Kryeministri grek theksoi se çështja nuk është vetëm dypalëshe, por lidhet edhe me respektimin e së drejtës europiane. Hapja dhe mbyllja e kapitujve të negociatave kërkon edhe miratimin e vendeve anëtare të Bashkimit Europian, ka thënë ai. Ndërsa për Maqedoninë e Veriut, kreu i qeverisë greke ishte edhe më i prerë, duke theksuar se nuk ka, në thelb, asnjë progres në negociatat europiane. Prandaj jemi në një fazë shumë më të hershme krahasuar me Shqipërinë, ka përfunduar ai.

Konferenca e shtypit erdhi një ditë pasi Mitsotakis shpalli nga Selaniku një paketë të gjerë masash ekonomike me rritje pagash dhe pensionesh, ulje taksash dhe ndihma për familjet, fermerët dhe bizneset, të cilat do t'i zbatojë nëse fiton edhe një mandat të tretë në pranverën e vitit 2027, kur janë parashikuar zgjedhjet parlamentare.

Partitë opozitare dhe disa media kritike ndaj qeverisë e pritën me skepticizëm fjalimin me masat ekonomike, ndërsa mijëra qytetarë, sindikata, fermerë dhe organizata protestuan në qendër të Selanikut të shtunën në mbrëmje kundër kostos së lartë të jetesës dhe politikave të qeverisë.

**Përgjigja e plotë e Mitsotakis:**

***Për më shumë se 20 vjet, Greqia mbështet perspektivën europiane të Ballkanit Perëndimor.Megjithatë, shumë nga dallimet që na ndajnë, si me Shqipërinë, ashtu edhe me Maqedoninë e Veriut, mbeten të pazgjidhura. A mendoni se i keni menaxhuar siç duhet marrëdhëniet me Tiranën dhe Shkupin? Mos ndoshta keni treguar tolerancë të tepruar në çështje që lidhen, për shembull, me pronat e anëtarëve të Pakicës Kombëtare Greke në Shqipëri dhe me moszbatimin e Marrëveshjes së Prespës nga qeveria e Mickoskit?***

**Kyriakos Mitsotakis:** *Greqia është në mënyrë të qëndrueshme në favor të perspektivës europiane të Ballkanit Perëndimor. Por kjo nuk do të thotë – dhe me të drejtë e vini në dukje – se çdo rast*

*nuk është i veçantë dhe se progresi i çdo vendi drejt Europës vlerësohet individualisht. Dhe, natyrisht, varet edhe nga gjykimi i të gjitha vendeve europiane se kur do të hapet dhe kur do të mbyllet çdo kapitull në kuadër të negociatave me Bashkimin Europian.*

*Me të drejtë theksuat se kemi ende çështje me pakicën kombëtare greke në Shqipëri, të cilat ia kemi bërë të ditura Shqipërisë. Nuk është i mjaftueshëm progresi që është bërë në evidentimin(regjistrimin) e pronave dhe në mbrojtjen e të gjitha të drejtave. Dhe të jeni absolutisht e sigurt se, në momentin e duhur, do të ushtrojmë të drejtat tona, në mënyrë që të jemi absolutisht të sigurt se të drejtat e pakicës mbrohen. Dhe e dini, kjo nuk është një çështje dypalëshe. Është një çështje që lidhet me të drejtën europiane, me mbrojtjen e të drejtave. Dhe, natyrisht, e njëjta gjë vlen edhe për Maqedoninë e Veriut, ku sigurisht nuk ka asnjë progres, në thelb, sa u përket negociatave europiane. Pra, atje, gjithsesi, jemi në një fazë shumë më të hershme në krahasim me atë që po ndodh me Shqipërinë.*


**Top Channel**

Kryesore »
5 minuta, 5 drama, Serie A pushtohet nga golat në minutat e fundit
06/09 23:17
Konflikt tek ish-Parku/ 26-vjeçari plagoset me mjet prerës, shoqërohet 53-vjeçari
06/09 23:00
Video/ Barazim dramatik në Torino, Gatti shpëton Juventusin nga humbja me Milanin
06/09 22:44
Ulrich Siegmung/ Nga shitës në një nga figurat më popullore në Gjermani, kush është 35-vjeçari që arriti fitoren historike të së djathtës ekstreme në Saksoni-Anhalt
06/09 22:25
VIDEO/ "Berisha n'burg", protestë jo vetëm në Tiranë, kryedemokrati pritet me thirrje kundër tij para takimit me diasporën në New Jersey
06/09 22:12
Thriller në aeroportin e Miamit/ Aeroplani i mallrave del nga pista dhe përplaset me automjetet, raportohet për të lënduar
06/09 22:07
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top News – Mitsotakis flet për Shqipërinë. 'Pronat dhe të drejtat e minoritetit mbeten problem'
Top News – Shembet ndërtesa në Delhi. Dhjetëra studentë bllokohen nën rrënoja
Top News – Erdogan, sërish ndërmjetës. Thirrje SHBA-Iran për të ulur gjakrat
Top Channel/ Zelensky: Luftë edhe gjatë dimrit! Ç'ndodhi me takimet e Kushner-Witkoff
Top Channel/ E frikshme! Zjarri jashtë kontrollit në Pukë, alarm dhe në Fier, Dajt e Kavajë
Top Channel/ E djathta ekstreme fiton bindshëm në Gjermani, CDU rënie dramatike
Kryesore
Konflikti në Vlorë, reagon biznesmeni Luan Muça: Shkova të sqarohem për pronën në Palasë, Bedinaj na priti me njerëz të armatosur që na sulmuan me plumba
16:59
Top Channel hap sezonin e ri/ Sara Hoxha: Pas 25 vitesh histori, ndryshojmë për të mbetur zgjedhja e parë e shqiptarëve
19:43
"Fëmijë jashtë martese"/ Trondit Eni Çobani në Grida Duma Podkast, kush është çifti i njohur që puthen e përqafohen në publik, por…
19:59
Droni me eksplozivë në aeroportin e Leipzigut, Lavrov kërcënon: Është fillimi i një lufte të vërtetë
13:51
Sërish spektakël nga Barcelona, katalanasit i japin "shuplakë" Valencias dhe kryesojnë të vetëm La Ligën
18:29
Më të lexuarat
"Fëmijë jashtë martese"/ Trondit Eni Çobani në Grida Duma Podkast, kush është çifti i njohur që puthen e përqafohen në publik, por…
Droni me eksplozivë në aeroportin e Leipzigut, Lavrov kërcënon: Është fillimi i një lufte të vërtetë
Përfundojnë rregullat e fleksibilitetit për kontrollet e hyrje-daljeve në BE, priten radhë të reja në kufi, linjat ajrore bëjnë paralajmërimin
"Ilir Meta ishte talent i madh politik", Rama: Nuk e mbajti dot peshën e pushtetit, u katandis në një personazh qesharak
Konflikti në Vlorë, reagon biznesmeni Luan Muça: Shkova të sqarohem për pronën në Palasë, Bedinaj na priti me njerëz të armatosur që na sulmuan me plumba
Fitorja e thellë e ekstremit të djathtë në Saksoni-Anhalt, zv.kancelari gjerman: Fitorja e AfD-së është një mesazh i qartë për Berlinin
Shqipëria drejt BE-së, Mitsotakis vendos theksin te pronat dhe minoriteti grek: Ka progres, por të drejtat e minoritetit grek nuk janë mbrojtur mjaftueshëm
"Askush nuk do ta fitojë këtë luftë", këshilltari i Zelenskyt paralajmëron shkatërrim: Nëse lufta me Rusinë vazhdon…
Video/ Broja përplaset me tifozin pas humbjes, sulmuesi i Kombëtares: Kam qenë jashtë për një vit
"Nuk jam shitësi i Shqipërisë", Rama paralajmëron nisjen e podkastit "Flasim": Nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës, pushteti…

- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

- Top Channel
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.